



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 352 prot.

Tiranë, më 23/02 2026

VENDIM

Nr. 21, datë 23.02 2026

**Shtimin e Sekretares Shkencore të Akademisë së Shkencave në Bordet Editoriale të dy
Revistave të Akademisë së Shkencave**

Në mbështetje të Rregullores për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të periodikëve shkencorë të Akademisë së Shkencave, neni 3 dhe neni 10, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 23.02.2026, në funksion të rritjes së vizibilitetit ndërkombëtar dhe forcimit të përfaqësimit institucional të revistave të Akademisë së Shkencave,

VENDOSI

1. Të shtohet Sekretare Shkencore e Akademisë së Shkencave, Akad. Anila Hoda si anëtare *ex officio* në bordin editorial të revistës Albanian Journal of Natural and Technical Sciences (AJNTS).
2. Të shtohet Sekretare Shkencore e Akademisë së Shkencave, Akad. Anila Hoda si anëtare *ex officio* në bordin editorial të revistës Studia Albanica.
3. Pjesëmarrja e Sekretares Shkencore në bordet editoriale dhe ushtrimi i detyrave të përcaktuara në këtë vendim synon:
 - a. forcimin e koordinimit ndërmjet strukturave drejtuese të Akademisë dhe redaksive të revistave;
 - b. rritjen e vizibilitetit, aksesit dhe impaktit ndërkombëtar të botimeve të Akademisë së Shkencave.
 - c. integrimin e dy revistave të Akademisë së Shkencave në platforma dhe databaza ndërkombëtare të indeksimit dhe shpërndarjes shkencore;
 - d. përmirësimin e përputhshmërisë së revistave me standardet editoriale, etike dhe teknike të kërkuara nga platformat ndërkombëtare të botimit shkencor.

- e. ndjekjen, koordinimin dhe përmirësimin e funksionimit të faqeve *online* të botimit të revistave, në përputhje me kërkesat teknike dhe editoriale të botimit shkencor elektronik.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder Gjinushi

